



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:287142
Datë: 21.02.2023
Numri i dokumentit: 03995822

Ka. nr. 12/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Subjekti ekonomik - Person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në magjistralen Podujevë – Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrritshëme, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri “Petroll Company” SH.P.K, përmes të autorizuarit Urim Vokshi, Avokat nga Prishtina, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 1280/21, të datës 11.11.2022, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 3, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 10.02.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga i pandehuri “Petroll Company” SH.P.K, përmes të autorizuarit Urim Vokshi, Avokat nga Prishtina, dhe
NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 1280/21, i datës 11.11.2022, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në magjistralen Podujevë – Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrritshëme, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 8000(tetë mijë)€, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, në Prishtinë, me numër të Ref. 19/20 të datës 16.12.2021, dhe me numër të Protokollit 10145, me aktgjykim K.nr. 1280/21, të datës 11.11.2022, të pandhurën Subjektin ekonomik – si person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në magjistralen Podujevë – Prishtinë, e ka shpall për gjegjëse sepse:

-me datë 02.12.2021, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të MTI-së, të Subjekti ekonomik - person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në magjistralen Podujevë – Prishtinë, është konstatuar në Procesverbalin e Inspektimit Nr.19/000241 se ushtron veprimtarin ekonomike pa Licencë për shitje me pakicë të GLN-së, me ç veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej **10.000(dhjetëmijë)€**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Me të njëjtin aktgjykim është obliguar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor – shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 5(pesë)€, në aftë të njëjtë sikurse edhe gjobën.

Kundër aktgjykimit ka ushtruar ankesë i pandehuri “Petroll Company” SH.P.K, përmes të autorizuarit Urim Vokshi, Avokat nga Prishtina, për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material me të cilin është paraparë kundërvajtja dhe vendimit mbi sanksionin kundërvajtës, në të cilën veç tjerash thekson se: në aktgjykim e ankimuar mungon arsyetimi pasi që nuk përmban arsye për faktet vendimtare kurse ato arsye dhe fakte të dhëna janë plotsisht të pa kuptueshme apo në mas të dukshme kundërtëse, gjykata e shkallës së parë thjesht ka konstatuar se “pas analizimit të dëshmisë së inspektorës së Tregut, provave të prezentuara nga palët që gjinden në shkresa të lëndës kjo gjykat ka vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme se i pandehuri ka kryer kundërvajtje e cila i vëhet në barr si në kërkesë”, një arsyetim i këtill jo vetëm që është i pa mjaftueshëm por është edhe i pasaktë pasi që vetëm nga deklaratat e inspektorës së tregut nuk mund të vërtetohet përgjegjësia e të pandehurit e aq ma tepër kur kjo dëshmi as nuk është paraqitur, andaj është e pa njohur çka e njëjta përmban. Po ashtu veprimi i të pandehurit nuk përmban kundërvajtje pasi që nuk del që i njëjti ka kryer kundërvajtjen për të cilën është shpallur përgjegjës. I pandehuri nuk mund të shpallet përgjegjës nga neni 6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, pasi që GLN - është substancë e veçantë, andaj sipas parimit **nullum crimen sine lege** një person nuk mund të shpallet përgjegjës e as të dënohet për një vepër e cila me legjislacionin e aplikueshëm nuk është përcaktuar si e dënueshme. Po ashtu Licenca për GLN –së, ashtë marr vetëm një muaj pas inspektimit, e po ashtu lartësia e sanksionit kundërvajtës duke pas parasysh se i pandehuri ka aplikuar për tu pajisur me licencë më datë 15.07.2021, ndërsa është pajisur me Licencë vetëm një muaj pas inspektimit gjykata e shkallës së parë është dasht në kuptim të nenit 36 të LK-së, ta pushoj procedurën kundërvajtëse pasi që janë menjanuar rrethanat e kundërligjshme andaj sanksioni i shqiptuar është shumë i lartë.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar të Ndryshohet ashtu që çështjen ta PEZULLOJ ndaj të pandehurit ose ta Anuloj dhe çështjen ta kthen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Kolegji i kësaj Gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, në bazë të deklaratës së Përfaqësuesit të së pandehurit Urim Vokshit, Avokat nga Prishtina, të dhënë pranë Gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 03.10.2022, i cili ka deklaruar se e kundërshton Kërkesën në tërësi dhe se në rastin e inspektimit kompania ka ushtruar kërkesë për tu pajisur me licën për GLN ndërkaq pas një muaji pas inspektimit edhe është pajisur me Licencë më datë 26.01.2022, andaj gjykata në kuptim të nenit 36 të LK-së, është dashtë ta pezulloj procedurën për arsye të mënjanimit të gjendjes kundërligjore, në bazë të Procesverbalit të Inspektimit Nr. 19/ 000241 të datës 02.12.2021, Licencës për Biznes në Sektorin e Naftës për shitje me pakicë të GLN-së, me afate të vlefshmërisë së Licencës prej 26.01.2022 deri më 25.01.2024, Licencës për Biznes në Sektorin e Naftës për shitje me pakicë të Dizellit dhe Benzinës me afate të vlefshmërisë së Licencës prej 02.09.2020 deri më 01.09.2022, Procesverbalit mbi marrjen në pyetje të Inspektores Fexhrije Salihu në cilësi të dëshmitares në Procesverbal të datës 31.10.2022, e cila ka deklaruar se gjatë inspektimit i njëjti nuk ka pas Licencë për shitje me pakicë të GLN-së, ashtu si që parashihet me ligj, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer vepër kundërvajtëse nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, të cilën gjykata bazuar në nenin 5 të LK-së, e ka ri - kualifikuar pasi që Ligji i cili është tani në fuqi është më i favorshëm për të pandehurin, po ashtu te përkufizimet në Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, në nenin 3 par. 1 pika 1.6. citim **“karburantet e naftës - karburantet e përfituara nga nafta, siç janë dizelli, benzina, karburanti në fushën e aviacionit, gazi i lëngëzuar i naftës, (GLN) gazoili, vaji i rëndë për nxehe, vajguri, koksi i naftës dhe produktet e tjera për djegie, që do të thotë se GLN është Karburant i naftës, andaj për këtë kundërvajtje mban përgjegjësi dhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për anulimin e aktgjykimin të ankimuar.**

Megjithatë, Kolegji duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese nga shkresat e lëndës, përkatësisht duke marrë parasysh se i pandehuri pas një muaji është pajisur me Licencë vendosi që ta NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person juridik “Petroll Company” SH.P.K, Njësia në magjistralen Podujevë – Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshëme, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 8000(tetëmijë)€, andaj duke marr parasysh se qëllimi i ndëshkimit nuk është dënimi i të pandehurit por përmirësimi i tij, Kolegji vendosi që aktgjykimin e goditur ta NDRYSHOJ, edhe sa i përket lartësisë së gjobës së shqiptuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke llogaritur se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse, të tilla apo të ngjashme.

Numri i lëndës: 2021:287142
Datë: 21.02.2023
Numri i dokumentit: 03995822

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 12/2023, me datë 10.02.2023



KRYETARIA KOLEGJIT,
Azra Cakolli

Lindita Rashiti

From: Shaban Gerxhaliu
Sent: Thursday, April 20, 2023 11:46 AM
To: Lindita Rashiti
Cc: Lebibe Haliti
Subject: RE: Aktgjykim

E nderuar,
Aktgjykimi i bashkangjitur nga ju është i formës së prerë nga që është vendosur nga gjykata e Apelit

Me respekt,



Shaban Gërxhaliu

Gjykata Themelore - Prishtinë

Administrator

Pallati i Drejtësisë, objekti A, kati i II, zyra 223

Tel: 038/200/17/361

www.gjygesori-rks.org



From: Lindita Rashiti
Sent: Thursday, April 20, 2023 10:34 AM
To: Shaban Gerxhaliu <shaban.gerxhaliu@rks-gov.net>
Cc: Lebibe Haliti <Lebibe.Haliti@rks-gov.net>
Subject: Aktgjykim

I nderuar,

Ju lutemi të na konfirmoni, se a ka marrë formën e prerë lënda K.nr.12/2023 ndaj operatorit ekonomik "PETROL COMPANY"-sh.p.k

Ju faleminderit për bashkëpunim!

Me respekt,
Lindita Rashiti